REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 90/17
Datë/Datum. 13.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Ak	Menaxherin e prokurimit: **Trepça-Ndërrmarrje në Administrim të AKP-së**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.90/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me vajra dhe yndyrna (lybrifikant për makinerit e minierës)"**, me nr. prokurimi: **12997/12998/17/433/121.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE NTP "Ballkan Petrol"- Ferizaj.**		
Datë	**13.04.2017.**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me vajra dhe yndyrna (lybrifikant për makinerit e minierës""**, me nr. prokurimi: **12997/12998/17/433/121,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Trepça-Ndërrmarrje në Administrim të AKP-së,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE NTP "Ballkan Petrol", me seli në Ferizaj, me nr.prot.**90/17**, i datës 30.03.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		06.04.2017		07.04.2017		13.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 30.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 90/17, e parashtruar nga operatori ekonomik NTP "Ballkan Petrol" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me vajra dhe yndyrna(lybrifikant për makinerit e minierës", me nr. prokurimi: 12997/12998/17/433/121/", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Trepça-Ndërrmarrje në Administrim të AKP.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: NTP "Ballkan Petrol"-Ferizaj.

Pikat e Ankesës:

- Neni 1 i LPP-së, (Qëllimi i Ligjit).
- Neni 7 i LPP-së, (Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi).
- Neni 28 i LPP-së, (Specifikimet Teknike).
- Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve).
- Neni 69 i LPP-së (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale).

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Me rastin e qasjes ne dokumentacionin e Operatorit Ekonomik te rekomanduar per kontrate, kemi hasur ne disa shkelje te LPP-se.Konsiderojme se A.K. "Trepça -Ndërrmarrje në Administrim të AKP" ka shkelur nenin 28 Specifikimet teknike

Arsyetim:

Konsiderojme se A.K. ka shkelur nenin 28 pasi që gjate vlersimit nuk i është përmbajtur kritereve të kërkuara në Dosje të Tenderit dhe në Specifikim teknik si ne vijim:

- Produkti 1 Vaj hidrol 68 ne specifikacionet e dhena ne DT eshte kerkuar parametri i pikes se ngrirjes te jete -27°C, ndersa OE ka ofruar -25°C.

- Produkti 3 Antifriz eshte kerkuar Antifriz koncentrat qe pas perzierjes 1:1 te kete temparaturen e ngrirjes deri ne -40°C, ndersa OE ka ofruar me temperature deri ne -37°C

Per produktin 8 per Minieren e Stantergut eshte kerkuar yndyre me baze sapuni te kalciumit, ndersa per Minieren ne Kishnices per produktin 3 ne formularin e pershkrimit te cmimeve eshte kerkuar yndyre me baze Litiumi. Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate (NTP "SNR") ka prezentuar te njejten certificate per te dy produktet edhe pse produktet qe kerkohenjane krejtesisht te ndryshem me njeri tjetrin. Per Minieren e Kishnices produkti i kerkuar me baze Litiumi kerkohet yndyre qe i reziston temperatures nga -30°C deri +130°C, ndersa ne certifikaten e ofertuesit temperatura rezistuese eshte prej -25°C deri +65°C. Me kete nenkuptohet se produkti i ofruar per Minieren e Kishnices nuk eshte produkt adekuat.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Arsyetim:

Me larte eshte argumentuar se O.E. i rekomanduar per nenshkrim te kontrates nuk i plotson te gjitha kriteret e kerkuara ne njoftim per kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Verejtje shtese;

Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate (NTP "SNR") ne dosjen e tij ka prezentuar certifikaten e kualitetit ISO 9001 dhe certifikaten e mjedisit ISO 14001 te prodhuesit ADECO me afat te skaduar.

Deshmi tjera gjate komunikimeve me Autoritetin kontraktuesjane te bashkangjitura me Ankese

Konkluzion:

Verejtjet e cekura me larte deshmojne se Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate (NTP "SNR") nuk i ka permbushur kriteret e kerkuara nga AK dhe per kete kerkojme qe Ankesen tone ta kualifikoj te bazuar dhe te kerkoj nga A.K. qe te behet anulimi i njoftimit per dhenje te kontrates dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....24.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedur e hapur/Vlerë e mesme
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 09.03.2017
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....09.03.2017-ora 13;00h
Njoftimi për dhënien e kontratës.....15.03.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	"NTP-SNR"		-	41.373,70€	JO
2	"Preberza" sh.p.k & "Mani"		-	51.683,12 €	JO
3	"Ballkan Petroll"	Ferizaj	-	45.601,28€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë tre (3) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net.
2. 2. Operatori ekonomik duhet të dorëzoj dëshmi lidhur me nenin 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nenparagrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4].
3. 3. Operatorit ekonomik duhet të deshmon se nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. [Neni 65 paragrafi 4, nënparagrafi 4.8].

Dokumentet e kërkuar në kërkesën nr. 2 dhe 3, duhet të dorëzohen nga OE fitues paranënshkrimit të kontratës.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1.Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e vet të themelimit (certifikata e biznesit),

2.Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin për TVSH.

3.Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin për numrin fiskal.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

N/A

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Zenel GASHI: Kryesues,
Isak MEHOLLI: Anëtar,
Pajazit TAHIRI; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 14.03.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni për vlerësimin e ofertave pas shqyrtimit të ofertave të cilat ishin tri (3) që të gjitha të përgjegjshme teknikisht si dhe nga ana administrative. Andaj komisioni është i mendimit që me kontrat të shpërblej OE NTP "SNR", i cili ka ofruar edhe çmimin më të ulët prej 41,373.70€.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, për furnizim, vlerë e mesme, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të datës 15.03.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, "Ballkan Petrol", me seli në Rakaj-Ferizaj, ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 30.03.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni:

- Neni 1 i LPP-së, (Qëllimi i Ligjit).
- Neni 7 i LPP-së, (Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi).
- Neni 28 i LPP-së, (Specifikimet Teknike).
- Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve).
- Neni 69 i LPP-së (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale).
-

Ekspertja shqyrtues bazuar në dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues ne me këtë aktivitet të prokurimit, në interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor 1,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 59 të LPP-së, konkretisht kriteret e kërkuar në FDT dhe njoftimin për kontrat, se OE i rekomanduar për kontrat NUK ka plotësuar kriteret e FDT-së, specifikimin teknik si dhe ka ofruar çertifikat të kualitetit ISO 9001 dhe çertifikaten e mjedisit ISO14001, me afat të skaduar.

Eksperti shqyrtues bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar për faktin se në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat NUK është kërkuar fare certifikata e kualitetit ISO 9001 dhe çertifikaten e mjedisit ISO14001, edhe pse të njëjtat dukemente gjinden në ofertën e OE të rekomanduar për kontrat,

Eksperti shqyrtues vlerëson se komisioni vlerësues gjatë vlerësimit, ekzaminimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në harmoni me nenin 59.4 e LPP-së si dhe nenin 41.1 të UOPP, duke përdoret gjate vlerësimit vetëm kriteret e matshme të cilat paraprakisht janë vendosur në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrat, si kritere të kualifikimit.

Pretendimi ankimor 2,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 28 dhe 69 të LPP-së, konkretisht specifikimit teknike Aneks 1, lidhur me mos përmbushjen e këtij specifikimi teknik nga ana e OE të rekomanduar për kontrat.

Eksperti shqyrtues bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar për faktin se në dosjen e tenderit aneks 1, janë kërkuar karakteristikat e produktit (vajrave) si dhe të posedojn ATESTET VALIDE, që ka të bëjë me implementimin e kontratës dhe të njëjtat specifikime NUK mund të përdoren në fazë e vlerësimit pasi që NUK është kërkuar katalogu siç pretendon OE ankues por janë kërkuar vetëm ATESTET për këto produkte që ka të bëjë me liferimin e mallit. Eksperti shqyrtues vlerëson se mbetet përgjegjësi e Autoritetit kontraktues që gjatë implementimit të kontrates të ketë parasysh kërkesat e FDT, specifimin teknike Aneks 1, në lidhje me karakteristik e produktit që të implementoj në përputhshmëri kontraten sipas specifikimit teknik të kërkuar në FDT.

Eksperti shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontrat në ofertën e tij gjinden katalogje për këto produkte por të njëjtit nuk mund të përdoren për vlerësim pasi që NUK kanë qenë kërkes e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet e OE ankues në lidhje me nenet e lartë cekura janë të pa bazuar, për faktin se Autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 1, 7, 28, 59 dhe 69 të LPP-së, ka bërë vlerësimin e ofertave, poashtu OE ankues është trajtuar të barabart në harmoni me nenin 7 të LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të REFUZOJ si të pa-bazuar ankesën OE "Ballkan Petrol", me seli në Ferizaj, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të APROVOJ vendimin e Autoritetit kontraktues "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 15.03.2017, me titull: Furnizim me vajra dhe yndyrna (lybrifikant për makinerit e minierës)", me nr. prokurimi: 12997/12998/17/433/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Trepça-Ndërrmarrje në Administrim të AKP-së..